Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), te Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 5, të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008" dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009 dhe konform nenit 15 dhe 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, ----------, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Suharekës për Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko-Theranda" Sh.A me seli në Rr. "Brigada123" në Suharekë, me këtë përbërje:

1. ---------- i/e emëruar nga Kuvendit Komunës-------anëtar/e
2. ---------- i/e emëruar nga Kuvendit Komunës-------anëtar/e
3. ---------- i/e emëruar nga Kryetari Komunës---------anëtar/e

Neni 2

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjin, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008" dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-9/2018" dhe ligjet dhe aktet nënligjore tjera që janë në fuqi.

Neni 3

3.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Theranda" Sh.A me seli në Rr. "Brigada123" në Suharekë.

3.2 Anëtaret e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 4

4.1 Mandat i anëtareve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S NË S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit
_____
Mr.ec Bexhet KUÇI